

## MBI AUDITIMIN E USHTRUAR NË UNIVERSITETIN “LUIGJ GURAKUQI” SHKODËR

Raporti Përfundimtar i Auditimit të ushtruar në *Universitetin “Luigj Gurakuqi” Shkodër*, me objekt: “*Mbi zbatimin e ligjshmërisë, rregullshmërisë ekonomiko-financiare dhe vlerësues, për periudhën 1/1/2009 deri më datën 30/9/2011*” dhe masat për përmirësimin e gjendjes, janë miratuar me Vendimin e Kryetarit të KLSH nr. 50, datë 12/4/2012.

Bazuar në nenet 9 dhe 16 të ligjit nr. 8270, datë 23/12/1997 “Për Kontrollin e Lartë të Shtetit”, ndryshuar me ligjin nr. 8599, datë 1/6/2000, me shkresën nr. 427/5, datë 12/4/2012 dërguar **Z. Artan Haxhi, Rektor i Universitetit “Luigj Gurakuqi” Shkodër**, krahas Raportit Përfundimtar të Auditimit, Kontrolli i Lartë i Shtetit i ka rekomanduar dhe kërkuar zbatimin e masave të mëposhtme:

### **A. MASA ORGANIZATIVE**

**1.** Nisur nga fakti se, në kundërshtim me nenin 15, të Statutit të Universitetit të Shkodrës, rregullorja e brendshme nuk është miratuar në Këshillin e Administrimit, Rektorati të kërkojë miratimin e saj në Këshillin e Administrimit.

**Menjëherë**

**2.** Nisur nga fakti se, në kundërshtim me pikën 3, të nenit 73, të ligjit nr. 7941, datë 21/5/2007 “Për Arsimin e Lartë në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, nuk është hartuar dhe miratuar nga Senati dhe Këshilli i Administrimit rregullorja mbi mënyrën e përdorimit të fondeve të krijuara nga të ardhurat, kërkojmë që të merren masat përkatëse për miratimin nga Senati dhe Këshilli i Administrimit të rregullores mbi mënyrën e përdorimit të fondeve të krijuara nga të ardhurat.

**Menjëherë**

**3.** Nga kontrolli u konstatua se, në kundërshtim me pikën 3 dhe 4 të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 432, datë 28/6/2006 “Për krijimin dhe administrimin e të ardhurave që krijojnë institucionet buxhetore”, i ndryshuar, nga Universiteti i Shkodrës janë miratuar dhe zbatuar tarifa financiare për realizimin e të ardhurave në shërbimet që kryen institucioni, pa marrë miratimin e Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës dhe të Ministrisë së Financave.

*Për këtë*, Universiteti i Shkodrës të kërkojë nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës që të përcaktohen dhe të miratohen me udhëzim të përbashkët midis saj dhe Ministrisë së Financave, tarifat financiare.

**Menjëherë**

4. Nga kontrolli i pagesave për pedagogët e jashtëm për vitet akademike 2009-2010 dhe 2010-2011, rezultoi se, janë paguar si pedagogë të jashtëm në Fakultetin e Shkencave të Edukimit (Departamenti i Mësuesisë) *mentorë*, në shumën bruto 5,600 mijë lekë dhe në Fakultetin e Shkencave të Natyrës (Departamenti i Infermierisë) *infermierë referent*, në shumën bruto 5,129 mijë lekë, pa u argumentuar dhe e mbështetur me bazë ligjore, pavarësisht nga miratimi i bërë nga Senati Akademik dhe Këshilli i Administrimit.

*Për këtë*, nga Universiteti i Shkodrës, në bashkëpunim me Ministrinë e Arsimit dhe Shkencës të hartohet baza e nevojshme ligjore për punësimin dhe pagesën e këtij stafi mbështetës në procesin mësimor.

### **Menjëherë**

5. Nga kontrolli u konstatua se, në kontratat e lidhura nuk është shënuar Fakulteti ku pedagogu duhet të ushtrojë detyrën, nuk është shënuar lënda dhe shërbimet e tjera që do të kryejë dhe me kryesorja nuk janë shënuar sa orë do të punojë gjithsej brenda afatit të kontratës, pa tejkalluar limitin e lejuar me pagesë, në kundërshtim me ligjin nr. 9741, datë 21/5/2007 “Për arsimin e lartë në RSH”, ndryshuar me ligjin nr. 9862, datë 12/11/2007, neni 50 “Punësimi në institucionet e arsimit të lartë”, pika 3.

*Për këtë*, Administrata e Universitetit të Shkodrës të marrë masa për të rishikuar të gjitha kontratat e lidhura dhe të përcaktojë në të, gjithë të dhënat e nevojshme për stafin e punësuar me kontratë.

### **Menjëherë**

6. Nga kontrolli u konstatua se, janë paguar orë mësimore për “Part Time” të kryera nga stafi akademik me kohë të plotë, sa dyfishi i orëve të ngarkesës mësimore sipas normativës dhe se numri i pedagogëve të jashtëm është gati dy herë më i madh se numri i pedagogëve të brendshëm, fakt ky që tregon se kërkesa për rekrutimin e pedagogëve të jashtëm nuk është bërë e studjuar mirë.

*Për këtë*, Administrata e Universitetit të marrë masa për të rishikuar strukturën e institucionit dhe ngarkesën mësimore, si dhe të plotësojë kërkesat me staf akademik të brendshëm

### **Menjëherë**

7. Nga kontrolli rezultoi se, inventarët fizikë të aktiveve nuk janë kryer për vitet 2009 dhe 2010, në kundërshtim me ligjin nr. 9228, datë 29/4/2004 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, i ndryshuar, neni 7, “Inventari i aktiveve dhe detyrimeve”.

*Për këtë, Sektori i Financës në Universitetin e Shkodrës të marrë masa për të kryer inventarizimin fizik e kontabël të pasurisë së institucionit, për të saktësuar rezultatin dhe për të bërë sistemimet kontabile në llogaritë inventariale.*

**Menjëherë**

**8.** Nga kontrolli i ushtruar rezultoi se, bilanci i Administratës së institucionit për vitin 2009 dhe vitin 2010 ka pasaktësi dhe mosrakordime të shifrave me ato të pasqyruara në librin e madh, veprime në kundërshtim me ligjin nr. 9228, datë 29/4/2004 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, i ndryshuar dhe aktet e tjera nënligjore.

*Për këtë, Sektori i Financës të marrë masa të regjistrojë dhe saktësojë shifrat e pasqyruara në dokumentacionin kontabël të viteve 2009, 2010 dhe 2011, duke bërë dhe sistemimet përkatëse në zbatim të ligjit nr. 9228, datë 29/4/2004 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, i ndryshuar.*

**Menjëherë**

#### **A. MASA PËR SHPËRBLIM DËMI**

**1.** Të merren masa për të kërkuar shpërblimin e dëmit **në vlerën 541,280 lekë**, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjyimit, nga subjekti ■■■■■, si rezultat i përfitimit të padrejtë nga rritja e paargumentuar e fondit limit, në zbatimin e kontratës me objekt “Mirëmbajtje ndërtimore dhe impiantistike”.

**Brenda datës 30/6/2012**

#### **B. MASA DISIPLINORE**

*Mbështetur në nenin 37, të Kodit të Punës, nenin 40, të Statutit të Universitetit të Shkodrës dhe nenin 16 të Rregullores së Brendshme të Universitetit, kërkojmë dhënien e masave disiplinore, si më poshtë:*

**“Vërejtje me paralajmërim për largim nga puna” për:**

**1. ■■■■■ me detyrë Kryetare e Degës së Financës, pasi:**

- Ka vepruar në kundërshtim me ligjin nr. 9228, datë 29/4/2004 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, i ndryshuar, VKM nr. 248, datë 10/4/1998, ndryshuar me VKM nr. 25, datë 20/1/2001 “Për miratimin e planit kontabël publik, për organet e pushtetit lokal, institucionet shtetërore, qendrore dhe lokale si dhe të njëjsete që varen prej tyre” dhe udhëzimeve të Ministrisë së Financave për nxjerrjen e llogarive vjetore, ku si rezultat në mbajtjen e kontabilitetit dhe nxjerrjen e

bilanceve të institucionit për periudhën objekt kontrolli ka pasaktësi e mosrakordime.

- Për vitin 2009 dhe 2010, nuk është kryer inventarizimi i pasurisë së institucionit, në kundërshtim me nenin 7, të ligjit nr. 9228, datë 29/4/2004 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, i ndryshuar dhe të VKM nr. 70, datë 11/3/1985 “Për administrimin, ruajtjen, dokumentimin dhe qarkullimin e vlerave materiale e monetare”, i ndryshuar.

**2. [REDAKTUAR] me detyrë Specialiste finance, pasi:**

- Ka vepruar në kundërshtim me ligjin nr. 9228, datë 29/4/2004 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, i ndryshuar, VKM nr. 248, datë 10/4/1998, ndryshuar me VKM nr. 25, datë 20/1/2001 “Për miratimin e planit kontabël publik, për organet e pushtetit lokal, institucionet shtetërore, qendrore dhe lokale si dhe të njëjstëve që varen prej tyre” dhe udhëzimeve të Ministrisë së Financave për nxjerrjen e llogarive vjetore, ku si rezultat në mbajtjen e kontabilitetit dhe nxjerrjen e bilanceve të institucionit për periudhën objekt kontrolli ka pasaktësi e mosrakordime.

- Për vitin 2009 dhe 2010, nuk është kryer inventarizimi i pasurisë së institucionit, në kundërshtim me nenin 7, të ligjit nr. 9228, datë 29/4/2004 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, i ndryshuar dhe të VKM nr. 70, datë 11/3/1985 “Për administrimin, ruajtjen, dokumentimin dhe qarkullimin e vlerave materiale e monetare”, i ndryshuar.

**“Vërejtje me shkrim” për:**

**1. [REDAKTUAR] me detyrë Specialiste e inventarizimeve dhe listëpagesave, pasi:**

- Për vitin 2009 dhe 2010, nuk është kryer inventarizimi i pasurisë së institucionit, në kundërshtim me nenin 7, të ligjit nr. 9228, datë 29/4/2004 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, i ndryshuar dhe të VKM nr. 70, datë 11/3/1985 “Për administrimin, ruajtjen, dokumentimin dhe qarkullimin e vlerave materiale e monetare”, i ndryshuar.

**2. [REDAKTUAR] me detyrë Kryetar i Degës së Blerjeve dhe Shërbimeve, në cilësinë e antarit të komisionit të inventarizimit, pasi:**

- Për vitin 2009 dhe 2010, nuk është kryer inventarizimi i pasurisë së institucionit, në kundërshtim me nenin 7, të ligjit nr. 9228, datë 29/4/2004 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, i ndryshuar dhe të VKM nr. 70, datë 11/3/1985 “Për administrimin, ruajtjen, dokumentimin dhe qarkullimin e vlerave materiale e monetare”, i ndryshuar.

**3. [REDAKTUAR] me detyrë Specialiste e numrit të punonjësve dhe pagave, në cilësinë e antarit të komisionit të inventarizimit, pasi:**

- Për vitin 2009 dhe 2010, nuk është kryer inventarizimi i pasurisë së institucionit, në kundërshtim me nenin 7, të ligjit nr. 9228, datë 29/4/2004 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, i ndryshuar dhe të VKM nr. 70, datë 11/3/1985 “Për administrimin, ruajtjen, dokumentimin dhe qarkullimin e vlerave materiale e monetare”, i ndryshuar.

**4. ■■■■■ me detyrë Kryetar i Degës së Burimeve Njerëzore,** në cilësinë e antarit të komisionit të inventarizimit, pasi:

- Për vitin 2009 dhe 2010, nuk është kryer inventarizimi i pasurisë së institucionit, në kundërshtim me nenin 7, të ligjit nr. 9228, datë 29/4/2004 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, i ndryshuar dhe të VKM nr. 70, datë 11/3/1985 “Për administrimin, ruajtjen, dokumentimin dhe qarkullimin e vlerave materiale e monetare”, i ndryshuar.

**5. ■■■■■ me detyrë magazinierë,** në cilësinë e antarit të komisionit të inventarizimit, pasi:

- Për vitin 2009 dhe 2010, nuk është kryer inventarizimi i pasurisë së institucionit, në kundërshtim me nenin 7 të ligjit nr. 9228, datë 29/4/2004 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, i ndryshuar dhe të VKM nr. 70, datë 11/3/1985 “Për administrimin, ruajtjen, dokumentimin dhe qarkullimin e vlerave materiale e monetare”, i ndryshuar.

*Shënim:* Auditimi u krye nga audituesit Selime Bicaj Përgjegjëse Grupi, Vladimir Vangjeli, Erjona Leka dhe Artan Zenelaj. Më tej u shqyrtua nga Kryeaudituesi i Departamentit zj. Luljeta Nano, Drejtori i Departamentit z. Ded Trieshi dhe Drejtore e Drejtorisë Juridike dhe Kontrollit të Cilësisë zj. Elvana Tivari, si dhe u verifikua si praktikë nga Drejtori i Përgjithshëm z. Robert Gjini.

**KONTROLLI I LARTË I SHTETIT**